



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
PËRFUNDIMTAR
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL
“DETARI”,

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

TIRANË, 2024

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Detari**”, **Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK**, individët i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “**Detari**”, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në në arsimin pas të mesëm ose të lartë.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin “**Detari**”, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetenca profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të marrë pjesë në kryerjen e një manovre të ç’akostim/akostimi nga bankina, të mjetit të lundrimit.	Detyra 1- “Lundrimi detar me anije”	35
2	Të kryejë një shërbim ndihmës në lokalin e makinerisë.	Detyra 2 – “Shërbime elektromekanike në sektorin e makinerisë së anijes”	35
3	Të kryejë një ose disa prej hapave që ndiqen për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes për zënie të produkteve ujore.	Detyra 3–“Krijimi dhe organizimi i ndërmarrjes për zënie të produkteve ujore.	15

Nr.	Kompetenca profesionale	Detyrat e punës	Pikët
4	Të kryejë një ose disa prej hapave që ndiqen për shitblerjen dhe promocionin e produkteve ujore.	Detyra 4 – “Shitblerja dhe promocioni në ndërmarrjen e zënies së produkteve ujore”	15
		Shuma	100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “detyra pune”, grupe pune në një ose më shumë prej proceseve të punës: në anije peshkimi ose tregtare në lundrim dhe/ose gjatë kohës së qëndrimit në port, në repartet e riparimit të veglave të peshkimit, në impiantet e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit fillestar të peshkut, që përbëjnë një kategori detyrash që shkolla nuk ka mundësi për realizimin e tyre në repartet përkatëse ku provimi praktik të mund të realizohet në një vend të grupuar duke respektuar dhe kohën në dispozicion.
- Për zhvillimin e programit të Provimit të Praktikës Profesionale të integruar, kërkon ushtrim domosdoshmërisht të aktivitetit përgatitor në mjetin e lundrimit, ku minimalisht, duhet të merret në konsideratë një mjet lundrimi me gjatësi jo më të vogël se 20 metra, në dispozicion të shkollës, për të paktën dy ditë, në kushte të favorshme të motit dhe detit. Kjo lidhet, me ndjesinë që përcjell kjo punë përgatitore në funksion të demonstrimit të kompetencave profesionale për nivelin përkatës të provimit.
- Koha për realizimin e detyrave në klasë duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë është shumë e domosdoshme respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë të përfshira domosdoshmërisht në vlerësim.
- Në vlerësimin e detyrave duhet t’i lihet hapësirë bashkëbisedimit profesional, ku komisioni drejton pyetje të parapërgatitura në pikat kyçe të procesit, por dhe në çdo rast kur e shikon të arsyeshme që duhet të ndërhyjë me pyetje, sepse bashkëbisedimi profesional është element shumë i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.

- Për çdo detyrë komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit të detajuar, duke pasur parasysh programin e zhvilluar në këtë nivel, në të gjitha modulet e detyruara të praktikës profesionale, sipas kompetencave përkatëse të përfshira në skeletkurrikul.
- Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, marrja e masave për sigurinë në punë, përdorimi i praktikave të punës sipas udhëzimit të instruktorit/kapitenit/kryemekanikut, raportimi i çdo situatë të konstatuar qoftë dhe me ecuri normale të punës, reagimi në raste emergjente si për sigurinë personale ashtu edhe atë kolektive.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka përfunduar detyrën, provimin.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.
- Për çdo detyrë komisioni i provimit përfshin në vlerësim dhe disa kompetenca të përgjithshme, të cilat janë të rëndësishme, si vetëkontrolli, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Këto të fundit janë me rëndësi të veçantë, pasi, siç dihet procesi teknologjik është me bashkëpunim dhe çdo detyrë, do të kërkojë përfshirjen e nxënësve për të arritur qëllimin .

Udhëzime për realizimin e Detyrës 1: “Lundrimi detar me anije”

Kjo detyrë do të realizohet në anije në port dhe/ose me simulim. Kapiteni jep udhëzimet përkatëse dhe demonstrimet konkrete të praktikave të aplikueshme të komunikimit detar, përdorimit të pajisjeve radio-navigacionale të instaluar në anije për një lundrim të sigurtë dhe me efikasitet të anijes.

Nxënësit duhet të vlerësohen duke punuar në grup, ata duhet të bëhet pjesë aktive në kryerjen/simulimin të paktën e një procesi pune si:

manovra e ç’akostimit nga bankina të anijes, në gjetjen e shmangies së busullës magnetike me objekte bregdetare teke ose me mbulim, në matjen e këndeve horizontale të objekteve bregdetare me pelengator, gjetjen e pozicionit të vendndodhjes dhe përdorimin e pajisjeve të radio - komunikimit detar A1 të instaluar në anije.

Për realizimin si duhet të detyrës është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e domosdoshme.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 2: “Shërbime elektromekanike në sektorin e makinerisë së anijes”

Kjo detyrë do të realizohet në anije në port. Mësuesi/mekaniku i caktuar nga komisioni për mbikëqyrjen e detyrës së nxënësit, duhet të përdorë situata të ndryshme të simuluar në lokalin e makinerisë.

Gjithashtu ata duhet të angazhohen në kryerjen të paktën në një nga proceset e punës në lokalin e makinerisë së mjetit të lundrimit.

Për realizimin e detyrës duhet të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e domosdoshme si, anije në port, anije në lundrim për qëllime peshkimi apo tregtare, mjetet e punës të disponueshme në anije etj.

Nxënësit organizohen në grupe të vogla pune ose në mënyrë individuale dhe angazhohen në veprimtari konkrete pune. Ata, nën mbikëqyrjen e mësuesit/mekanikut, kryejnë një nga proceset e punës si:

mirëmbajtje/riparime të thjeshta në motorin dhe në motorin ndihmues të mjetit lundrues, kontrollojnë punën e agregateve dhe sistemeve për defekte dhe marrin masat paraprake, shërbime mirëmbajtëse/riparuese të thjeshta të pompës së ujit të detit, të sistemit zjarrfikës të anijes etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Edhe në këtë detyrë vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 3: “Krijimi dhe organizimi i ndërmarrjes për zënie të produkteve ujore”

Kjo detyrë duhet të realizohet në mjediset e firmës ushtrimore të shkollës me simulim, ku mësuesi i praktikës bën ndarjen e detyrave në grupe pune dhe i mbikëqyr ata në disa prej hapave që ndjekin për realizimin e detyrës.

Nxënësit në grupe kryejnë një nga proceset e studimit fillestar për krijimin e ndërmarrjes së zënies së produkteve ujore, përcaktimin e formës juridike të ndërmarrjes për gjuetinë e peshkut në det dhe dokumentacionin bazë të saj, bëjnë aplikimin për regjistrim në organet përkatëse, identifikojnë nevojat për personel dhe kryejnë një simulim të procedurës së rekrutimit dhe punësimit të personelit.

Për realizimin e detyrës duhet të sigurohen mjetet dhe pajisjet e punës për krijimin e organizimit e ndërmarrjes si:

mjete kancelarie, kompjuter në lidhje me internetin, program kompjuterik për menaxhimin e aktivitetit në ndërmarrje për zënie e produkteve ujore, modele statutesh, akte themelimi, plane biznesi, dosje aplikimi në QKB të marra nga ndërmarrje konkrete për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes, formularë regjistrimi në QKB, pasqyra dhe deklarata për numrin e të punësuarve, kontrata me sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe deklarata të parashikimit të fitimit etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të përdoret listë kontrolli e përgatitur më parë. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 4: “Shitblerja dhe promovimi në ndërmarrjen e zënies së produkteve ujore”

Kjo detyrë realizohet në mjediset e shkollës me simulim për një bashkëpunim sa më të mirë me njëri-tjetrin, për realizimin e promovimit të imazhit të ndërmarrjes dhe reklamës së produktit.

Nxënësit angazhohen në veprimtari konkrete pune duke analizuar me simulim një ose disa hapa të bashkëpunimit si: furnitorët potencialë në fushën e biznesit dhe duke vendosur marrëdhënie me ta, duke identifikuar nevojat dhe furnitorët për blerje, nevojat për personelin, kryerjen e blerjeve dhe regjistrimin e tyre për biznesin e personelin, duke analizuar klientët potencialë në fushën e biznesit, nxitur marrëdhëniet me këta klientë potencialë dhe aktualë, kryerjen e shitjeve dhe regjistrimeve përkatëse, kryerjen e blerjeve dhe shitjeve për biznesin dhe personelin në Web-shop (markatën elektronike të peshkut) etj.

Gjithashtu nxënësit realizojnë një nga elementët e mëposhtëm si:

politikat e produktit të ndërmarrjes së zënies së produkteve ujore dhe si realizohet reklama e ndërmarrjes së zënies së produkteve ujore. Ata angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e një stende të materialeve të shkruara të reklamës dhe promocionit apo për kryerjen e veprimeve përgatitore për pjesëmarrjen në panair, bisedave të shitjes në panair, si dhe veprimeve të nevojshme gjatë panairit dhe pas panairit.

Për realizimin e detyrës është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

mjediset e firmave ushtrimore, materiale kancelarie, dokumente të ndryshme korrespondence, model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi/instruktori, dëftesa lëvrimi, formularë, fatura, regjistra të blerjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme, fletëpalosje dhe materiale të ndryshme reklame të marra në ndërmarrje të ndryshme, statistika të panairove të mëparshme të përpunuara nga nxënës të viteve të kaluara, materiale të ndryshme audio-vizuale, foto, filma që ilustrojnë paraqitje në panair të mëparshme, materiale të ndryshme informative të marra nga tregu i sektorit, kompjuter me programe të ndryshme animimi dhe përpunimeve grafike; si dhe lidhje interneti.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të përdoret listë kontrolli e përgatitur më parë. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.